



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/Th8-11 Prot.

Tiranë 03.09.2025

Nr. Dok. 202500624/11

Lënda: Rekomandime për përmbushjen e detyrimeve ndaj Shoqatës së të Verbërve,
Dega Berat

BASHKISË BERAT

Për dijeni: Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Berat

Shoqata e të Verbërve – dega Berat

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar dy ankesa nga Shoqata e të Verbërve, Dega Berat, lidhur me mungesën e mbështetjes financiare dhe mungesën e një mjedisi pune (zyre) për këtë shoqatë nga ana e Bashkisë Berat, gjatë një periudhe prej rreth tre vitesh. Konkretisht, Shoqata parashtron në ankesën e saj se nuk është financuar për aktivitetet e saj dhe se kërkesat e përsëritura drejtuar Bashkisë Berat për pajisjen me një zyrë funksionale janë refuzuar vazhdimisht. Në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ka nisur hetimi administrativ për këtë çështje me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar (të verbër) në qarkun Berat.

Me shkresat tona nr. 202401487/2, dhe 202401488/2 të datës 23.10.2024, drejtuar Bashkisë Berat të cilat u përsëritën me tonat në datat 14.11.2024 dhe 20.12.2024 (duke qënë se nuk pati përgjigje për kërkesat e para) u kërkuar sqarime lidhur me pretendimet e shoqatës. Në përgjigjen zyrtare të bashkisë (shkresa nr. 7196/1, datë 22.01.2025), u deklarua se Bashkia Berat

dhe Drejtoria e Shërbimit Social kanë pasur ndër vite një bashkëpunim të mirë me Shoqatën e të Verbërve (Dega Berat). Sipas asaj përgjigje, bashkia pohon se shoqata është përfshirë rregullisht në trajnime dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga Bashkia dhe Drejtoria e Shërbimit Social. Në lidhje me financimin, pretendohet se Shoqata e të Verbërve (Berat) “nuk ka paraqitur asnjëherë kërkesë për financim apo draft-projekt për financim” pranë bashkisë. Gjithashtu bashkia shprehet se ankesa e shoqatës, për pjesën e financimit, i drejtohet Këshillit të Qarkut Berat dhe jo vetë Bashkisë Berat.

Duke e vlerësuar si të paplotë përgjigjen e mësipërme, Avokati i Popullit i është drejtuar sërish Bashkisë Berat me shkresën nr. 202500624/8, datë 29.05.2025, duke kërkuar informacion të detajuar dhe sqarime specifike. Në këtë shkresë janë ngritur pyetje të qarta rreth:

- *Planifikimit të mundshëm nga ana e bashkisë në buxhetin vjetor apo planin social vendor të fondeve për mbështetjen e Shoqatës së të Verbërve, Dega Berat (siç parashikohet në nenin 13 të ligjit nr. 8098/1996 “Për statusin e të verbërit”).*
- *Arsyet pse, nëse fonde të tilla nuk janë planifikuar, ka munguar një planifikim i tillë, pavarësisht se kjo shoqatë përfaqëson një kategori me status të veçantë ligjor dhe që gëzon mbrojtje të posaçme.*
- *Procedurat, kriteret dhe mekanizmat që Bashkia Berat zbaton për të mbështetur financiarisht ose nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë persona me aftësi të kufizuara.*
- *Iniciativat eventuale në Këshillin Bashkiak për mbështetjen e Shoqatës së të Verbërve me fonde nga buxheti vendor apo fondi social i bashkisë (duke kërkuar edhe vënien në dispozicion të çdo procesverbali përkatës, nëse ka pasur diskutime të tilla).*
- *Qëndrimin e bashkisë lidhur me përgjegjësinë institucionale: nëse Bashkia Berat e konsideron se mbështetja financiare e shoqatës është detyrë e një institucioni tjetër (p.sh. e Qarkut apo qeverisë qendrore), a ka ndërmarrë ajo ndonjë hap konkret për ta adresuar këtë çështje në nivelin e duhur.*
- *Kërkesën për vendosjen në dispozicion të një mjedisi pune (zyre) për shoqatën, duke pyetur: a është trajtuar ndonjëherë kjo kërkesë në strukturat e bashkisë; nëse po, arsyet e refuzimit; nëse ka ambiente të lira publike që mund të ofrohen; nëse Bashkia e ka konsultuar Këshillin Bashkiak për këtë çështje; cilat janë kriteret për dhënien në*

përdorim të ambienteve për OJF dhe a është përjashtuar Shoqata e të Verbërve nga këto kritere; si edhe çfarë masash ka marrë Bashkia për të garantuar aksesueshmërinë fizike të ambienteve të saj për personat me aftësi të kufizuara (në përputhje me detyrimet e ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”).

Me shkresën nr. 3001/1, datë 09.07.2025, Bashkia Berat ka kthyer një përgjigje ndaj kërkesës sonë të dytë. Në këtë përgjigje citohet një bazë e gjerë ligjore (ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”, VKM nr. 597, datë 04.09.2019 i ndryshuar, ligji nr. 8098/1996 “Për statusin e të verbërit”, ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj.), dhe parashtrohet se: *Marrëdhëniet e Bashkisë dhe Drejtorisë së Shërbimit Social me Shoqatën e të Verbërve (Berat) kanë qenë tradicionalisht shumë të mira dhe “rigoroze”. Bashkëpunimi përshkruhet si i shumëanshëm, përfshirë: respektimin korrekt të afateve të pagesave (ndihma ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar), informimin dhe asistimin e personave të verbër për dokumentacionin apo problematikat e tyre duke i shoqëruar pranë institucioneve të tjera, përfshirjen e tyre në trajnime të ndryshme mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, pajisjen me karroca me rrota për personat e verbër që kanë nevojë, etj.* Gjithashtu, bashkia thekson se ky grup përfiton edhe nga shërbime të tjera publike, si strehimi social, infrastruktura e përshtatur, përjashtime apo lehtësira në taksa dhe tarifa vendore, etj. Lidhur me planifikimin buxhetor dhe planin social vendor, bashkia shprehet se ato janë “gjithëpërfshirëse”, duke nënkuptuar se ndërhyrjet planifikohen në shumë dimensione që prekin edhe kategorinë e të verbërve. Megjithatë, nuk jepen detaje konkrete nëse një linjë e veçantë buxhetore apo fond specifik i dedikuar shoqatës në fjalë ekziston ose jo. Për sa i takon mbështetjes financiare të drejtpërdrejtë Bashkia deklaron se “është e hapur në çdo kohë” për të shqyrtuar një kërkesë të detajuar nga Shoqata e të Verbërve për mbështetje në ndonjë aktivitet konkret, të cilin ajo (shoqata) do të zhvillojë, me kusht që aktiviteti të jetë i mbështetur ligjërisht. Një kërkesë e tillë, sipas bashkisë, do të paraqitej për miratim edhe në Këshillin Bashkiak. Vlen të theksohet se përgjigjja e mësipërme e bashkisë nuk i është përgjigjur drejtpërdrejt disa prej pyetjeve specifike të ngritura nga institucioni ynë. Në përgjigje mungon informacion i qartë nëse janë planifikuar ose jo fonde konkrete për Shoqatën e të Verbërve (p.sh. në buxhetin e vitit 2023-2025), cilat ishin arsyet e mos-planifikimit (nëse është rasti), si dhe asnjë referencë ndaj

çështjes së vënies në dispozicion të një zyre për shoqatën. Për çështjen e zyrës nuk ka asnjë sqarim në përgjigjen e fundit, megjithëse kjo pyetje ishte një pyetje e qënësishme e ankesës dhe e kërkesës sonë për informacion.

Avokati i Popullit vlerëson se është i qartë fakti që Shoqata e të Verbërve, Dega Berat, nuk ka përfituar mbështetje financiare të dedikuar nga Bashkia Berat për një kohë të gjatë (të paktën tri vitet e fundit sipas ankuesve). Po ashtu, kjo shoqatë nuk disponon aktualisht një ambient/zyrë të akorduar nga bashkia¹, gjë që vështirëson funksionimin e saj të përditshëm dhe ofrimin e shërbimeve e aktiviteteve komunitare. Bashkia, në përgjigjet e saj, ka theksuar aspektet pozitive të bashkëpunimit të deritanishëm (kryesisht në zbatimin e detyrimeve ligjore ekzistuese ndaj individëve me status të verbër), por nuk ka dhënë zgjidhje apo angazhim konkret për dy kërkesat kryesore të shoqatës: *(i) mbështetjen me fonde për veprimtaritë dhe (ii) sigurimin e një mjedisi pune/zyrë*. Nga informacioni i administruar, rezulton gjithashtu se përfaqësuesja e Shoqatës së të Verbërve, Dega Berat, znj. Thimie Gjika (ankuesja kryesore), ka ndërruar jetë gjatë kohës së trajtimit të kësaj ankese. Kjo e bën edhe më urgjente trajtimin institucional të çështjes, me qëllim që anëtarët e tjerë të komunitetit të personave të verbër në qarkun Berat të kenë mbështetjen dhe përfaqësimin e duhur, pavarësisht ndryshimeve në drejtimin e shoqatës. Mospërmblidhja e kësaj detyre nga Bashkia Berat deri më sot (duke mos i siguruar një zyrë shoqatës) bie ndesh me frymën e ligjit dhe cenon funksionimin normal të shoqatës. Edhe pse neni 13 i ligjit “Për statusin e të verbërit” i referohet “shtetit” në mënyrë të përgjithshme, duhet interpretuar se ky detyrim zbatohet në praktikë nga strukturat përkatëse të pushtetit, në nivel qendror dhe vendor, secila brenda kompetencave të veta. Për çështje të karakterit lokal (siç është vendosja e zyrave për degët vendore të shoqatës dhe mbështetja e aktiviteteve komunitare), **bashkia është autoriteti kryesor përgjegjës**, pasi ajo administron pronën publike vendore dhe harton buxhetin e njësisë. Transferimi i përgjegjësisë tek një institucion tjetër si Këshilli i Qarkut, pa ndërmarrë vetë hapa, nuk gjen mbështetje ligjore të qartë. Në rast se vërtet ekzistojnë kompetenca paralele apo plotësuese të qarkut në këtë drejtim, duhet që Bashkia Berat të koordinohet institucionalisht me Këshillin e Qarkut Berat ose me institucionet qendrore për

¹ Neni 13 i ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar) përcakton qartë se “*Shteti mbron dhe përkrah Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë... Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve... sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim. Shteti vë në dispozicion... mjedise pune në qendër dhe në rrethe, të cilat ua jep në përdorim.*” Sipas këtij parashikimi ligjor, në çdo rreth (qark) përkatës, autoritetet vendore duhet të mundësojnë një zyrë ku degët lokale të shoqatës të kenë kushte minimale për ushtrimin e veprimtarisë.

zgjdhjen e problemit, në vend që thjesht të orientojë shoqatën drejt tyre, apo të mos i kthejë fare përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit për këtë çështje, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret. Mungesa e një përgjigje shteruese nga ana e Bashkisë Berat mbi çështjet e ngritura (vecanërisht ato lidhur me buxhetimin e fondeve dhe ofrimin e një zyre) përbën një mangësi në aspektin e transparencës dhe cenon parimin e bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit. Ky i fundit, në përmbushje të mandatit të vet, ka të drejtë të marrë përgjigje të argumentuara dhe, kur konstaton parregullsi apo nevoja për përmirësim, të japë rekomandime.

Për sa më lart, legjislacioni i sipërcituar i jep Bashkisë Berat **detyrimin dhe njëkohësisht mundësinë** për të adresuar shqetësimet e ngritura nga Shoqata e të Verbërve, Dega Berat. Në këto kushte, me qëllim garantimin e një cilësie jetese dinjitoze për personat e verbër dhe për anëtarët e Shoqatës së të Verbërve, Dega Berat, që jetojnë në territorin e Bashkisë Berat, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

dhe në vijim të nenit 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se:

“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut...”*.

R E K O M A N D O J M Ë:

1. *Marrjen e masave nga Bashkia Berat për planifikimin dhe akordimin e mbështetjes financiare për Shoqatën e të Verbërve, Dega Berat;*
2. *Marrjen e masave nga Bashkia Berat për të mundësuar pajisjen e Shoqatës së të Verbërve, Dega Berat me një zyrë funksionale brenda territorit të qytetit të Beratit, sa më parë të jetë e mundur. Ky ambient pune duhet të jetë i përshtatshëm dhe i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, duke respektuar standardet për aksesueshmërinë;*

3. *Marrjen e masave nga Bashkia Berat për përmirësimin e komunikimit dhe transparencës me institucionet mbikëqyrëse dhe të sigurohet që në të ardhmen çdo kërkesë për informacion apo rekomandim nga Avokati i Popullit të trajtohet me seriozitet të plotë, brenda afateve ligjore, dhe me përgjigje të qarta e konkrete për çështjet për të cilat kjo bashki adresohet nga Avokati i Popullit.*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,* lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

d.v.